

FINANCA

BULETINI MUJOR | DHJETOR 2025



KUVENDI MIRATON BUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN 2026 DHE PAKETËN FISKALE

Kuvend i Shqipërisë miratoi në seancë plenare, nen për nen dhe në tërësi, buxhetin e shtetit për vitin 2026 dhe projektligjet e paketës fiskale që e shoqërojnë atë. Buxheti 2026 mbështet objektivat strategjikë të qeverisë, duke siguruar mirëqenie dhe mbrojtje sociale, mbështetje për integrimin europian, rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe konsolidimin fiskal. Kryefjala e buxhetit 2026 është: Pensionet, pasi, përtej indeksimit

vjetor që zbatohet rregullisht, për vitin 2026 do të ketë edhe rritje mujore të pensioneve me një efekt financiar të parashikuar në rreth 10.4 miliardë lekë. Buxheti i vitit 2026 parashikon: Të ardhura buxhetore në vlerën 823.1 miliardë lekë ose 29.6% e PBB, 52.9 miliardë lekë më shumë se sa viti 2025; Shpenzime buxhetore në vlerën 886.8 miliardë lekësh, ose 31.9% të PBB-së, me një rritje prej rreth 55 miliardë lekësh, krahasuar me vitin 2025. Investime Publike të planifikuara në masën 179.6 miliardë lekë ose 6.5% e PBB.

► LEXO MË SHUMË

DEKLARATË E MINISTRIT PETRIT MALAJ MBI AKTIN NORMATIV PËR NDRYSHIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025

Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 11 për ndryshimin e buxhetit të vitit 2025. Në një deklaratë për mediat, Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, informoi se një prej çështjeve kryesore që u miratua përmes këtij akti është mbështetja financiare për familjet që përfitojnë Ndihmë Ekonomike si dhe për Personat me Aftësi të Kufizuar, apo kujdestarët e tyre. Ministri tha se masa e mbështetjes financiare, në formën e bonusit të fundvitit, do të jetë 15 mijë lekë apo rreth 150 euro

dhe në total nga kjo nismë do të përfitojnë rreth 148,500 qytetarë, me një fond total prej 2.2 miliardë lekë. Një tjetër çështje që adresohet përmes aktit normativ lidhet me përdorimin e fondeve nga ana e ministrive apo institucioneve buxhetore. Ministri Malaj informoi se të gjitha fondet, të cilat nuk do të shpenzohen nga ministrinë apo institucionet buxhetore, do të kalojnë në Fondin e Veçantë të Pensioneve pranë Bankës së Shqipërisë. Nga një vlerësim paraprak që ka bërë Ministria e Financave, vlerësohet se shuma që minimalisht do të kalojë në këtë llogari do të jetë në masën 150 milionë euro.

► LEXO MË SHUMË



PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-NËNTOR 2025

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Nëntor 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale arritën në rreth 687.7 miliardë lekë, një realizim në masën 99 % të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mblodhën rreth 39.7 miliardë lekë më shumë ose 6.1 % më shumë. Në terma vjetorë, të ardhurat totale për 11 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 89.3 % të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025, dhe në masën rreth 91 % të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar. Shpenzimet e përgjithshme publike arritën në rreth 688.6 miliardë lekë me një realizim në masën rreth 91% e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ky zë ka rezultuar rreth 11% përqind më i lartë ose rreth 62.2 miliardë lekë më shumë.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ NË TAKIMIN ME BIZNESIN: SIPËRMARRJA, PARTNER STRATEGJIK NË HARTIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE



Ministri Petrit Malaj mori pjesë në takimin me përfaqësues të biznesit, me pjesëmarrjen edhe të Kryeministrit Edi Rama dhe të Ministrës së Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj. Në fjalën e tij, Ministri Malaj theksoi rëndësinë e dialogut të

vazhdueshëm dhe partneritetit mes qeverisë dhe sipërmarrjes, si një element kyç për zhvillimin ekonomik dhe integrimin europian të vendit. Ministri Malaj nënvizoi se sipërmarrja mbetet partner strategjik në hartimin e politikave të qeverisë, duke theksuar se shumë nga reformat fiskale dhe ekonomike janë ndërtuar mbi kërkesat dhe shqetësimet e komunitetit të biznesit. Z. Malaj solli si shembull ligjin e Paqes Fiskale dhe ligjin për faljen e detyrimeve tatimore dhe doganore, të cilat u konceptuan pas konsultimeve me biznesin dhe në përputhje me praktikat më të mira europiane, duke garantuar njëkohësisht stabilitetin fiskal dhe drejtësinë ndaj tatimpaguesve të rregullt.

► LEXO MË SHUMË



REFORMA E TAKSËS SË PASURISË, PËRMBYLLET PROJEKTI “PROTAX ALBANIA”

Ministri i Financave mori pjesë në eventin e mbylljes së projektit “ProTax Albania”, ku vlerësoi rëndësinë e tij si një projekt në linjë me reformat që po ndërmerr qeveria shqiptare, në kuadër edhe të procesit të integrimit të vendit në BE. Qëllimi kryesor, tha z. Malaj, është garantimi i një taksimi të drejtë dhe efikas të pronës në Shqipëri, si dhe forcimi i rolit të bashkive për mbledhjen e kësaj takse shumë të rëndësishme. Zbatimi i projektit synonte garantimin e reformës së taksës së pasurisë, bazuar në vlerën e tregut, krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme

të Taksës së Pasurisë dhe ndërtimin e Kadastrës Fiskale. Ministri informoi se tashmë është hartuar projektligji i ri për Taksën e Pasurisë dhe është ngritur Kadastro Fiskale, me informacione të qendëruara, bazuar në një sistem unik dhe me standarde europiane. Rugëtimi drejt reformimit të plotë, tha Ministri, nuk ka përfunduar, ndërsa theksoi se Taksa mbi pronën duhet të jetë taksa më kontributive dhe më e rëndësishme për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI PETRIT MALAJ MERR PJESË NË FORUMIN E DOHA-S NË KATAR

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, zhvilloi një takim me Ministrin e Financave të Shtetit të Katarit, z. Ali bin Ahmed Al Kuwari, gjatë pjesëmarrjes së tij në Doha Forum, në Katar. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe financiar ndërmjet dy vendeve, si dhe

mbi mundësitë për projekte të përbashkëta, që mund të mbështesin investimet, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ministri Malaj vlerësoi partneritetin mes Shqipërisë dhe Katarit dhe shprehu angazhimin për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në fusha me interes të ndërsjellët. Takimi konfirmoi vullnetin e të dy palëve për të zgjeruar partneritetin strategjik dhe për të krijuar ura të reja bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Katarit.

► LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ ZHVILLOI NJË TAKIM ME DREJTUES TË BANKËS BOTËRORE, MIGA DHE IFC

Në kuadër të bashkëpunimit me Bankën Botërore, MIGA dhe IFC, Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, zhvilloi një takim me drejtues të këtyre institucioneve, të kryesuar

nga Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor pranë Bankës Botërore, znj. Xiaoqing Yu. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi ecurinë e bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe institucioneve partnere, ku u vlerësua mbështetja e vazhdueshme dhe e gjithanshme për qeverinë shqiptare. Aktualisht është duke u hartuar portofoli i ri i mbështetjes për financimin e projekteve më të

rëndësishme në periudhën afatmesme. Ministria e Financave, nga ana e saj, po monitoron me kujdes ecurinë e zbatimit të projekteve që janë në vijim, për të garantuar arritjen e objektivave, në një kohë që investimet strategjike dhe performanca e projekteve mbeten kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI PETRIT MALAJ MERR PJESË NË KONFERENCËN KOMBËTARE TË FINANCAVE TË KLIMËS

Ministri i Financave mori pjesë në Konferencën Kombëtare të Financave të Klimës, organizuar nga Ministria e Mjedisit, me synim diskutimin mbi strategjitë për mobilizimin e fondeve për klimën në

vend, në kuadër të Paktit të Gjelbër të BE-së dhe Programit të Gjelbër të Ballkanit Perëndimor. Në diskutimin e tij, Ministri Malaj u fokusua në stabilitetin ekonomik të vendit tonë dhe gatishmërinë për financimin klimatik, duke theksuar se financimi klimatik nuk është vetëm një çështje teknike apo zhvillimore, për një sfidë globale që lidhet me

besimin te institucionet, qeverisja ekonomike dhe angazhimi afatgjatë. Shqipëria, tha z. Malaj, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, përmes konsolidimit të qëndrueshëm makro-fiskal, reformave strukturore dhe forcimit institucional.

► LEXO MË SHUMË



MIRËQEVERISJA DHE PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE – PREZANTIMI I VLERËSIMEVE PEFA NË NIVEL VENDOR

Nën drejtimin e Drejtoreshës së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, znj. Mimoza Dhëmbi, dhe Zv.Ambasadorit të Zvicrës në Tiranë, z. Philipp Arnold, si dhe me prezencën e përfaqësuesit të SECO në Shqipëri z. Aurèle

Cotton, u zhvillua aktiviteti “Dissemination Event for Sub-national PEFA Assessments in Albania”. Ky takim u organizua nga ekipi i ekspertëve që realizuan vlerësimet PEFA në nivel vendor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pesë bashkive të përzgjedhura: Tiranë, Fier, Kuçovë, Berat dhe Tropojë, si dhe përfaqësuesve nga Ministria e Financave. Rezultatet e vlerësimeve tregojnë një progres të dukshëm krahasuar me vitin 2017, veçanërisht në planifikimin buxhetor dhe lidhjen e tij me objektivat strategjike, në përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe auditimit, si dhe në administrimin e të ardhurave vendore, ku janë evidencuar praktika më të strukturuar dhe menaxhim më efikas i taksave.

► LEXO MË SHUMË

PREZANTOHET PËR HERË TË PARË MANUALI DOGANOR PËR PASAGJERËT

Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave zhvilluan një inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” me fokus prezantimin e Manualit Doganor për Pasagjerët, një botim i ri dhe thelbësor i Administratës Doganore Shqiptare. Ky manual, i publikuar për herë të parë, përmbledh në një dokument të vetëm rregullat kryesore për hyrjen dhe daljen e pasagjerëve nga territori shqiptar, duke ofruar udhëzime të qarta mbi mallrat e lejuara dhe të ndaluara, deklarimin e valutës, barnat, kafshët shtëpiake, mbrojtjen e pasurive kulturore dhe procedurat për mjetet e transportit. Gjatë inspektimit, Ministri i Financave nënvizoi rëndësinë e këtij botimi për lehtësimin e udhëtimit dhe shmangien e penaltiteve.

► LEXO MË SHUMË



KUVENDI MIRATOI KATËR PROJEKTIGJE TË PROPOZUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE

Kuvendi i Shqipërisë miratoi katër projektligje të propozuara nga Ministria e Financave, të cilat u prezantuan fillimisht nga Ministri z. Petrit Malaj. Përmes tre projektligjeve sigurohet financimi i një prej projekteve më të rëndësishëm hekurudhorë në vend, ai i rehabilitimit dhe modernizimit të linjës Durrës – Rogozhinë. Ministri Malaj theksoi faktin se ky projekt përbën një investim strategjik në garantimin e një ndërlidhjeje kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa shënon fazën e parë të funksionimit të Korridorit Hekurudhor VIII. Ministri informoi se kostoja totale e projektit parashikohet në vlerën e rreth 120.5 milionë eurove dhe do të financohet përmes një bashkëpunimi të ngushtë me institucionet financiare ndërkombëtare dhe Bashkimin Evropian.

► LEXO MË SHUMË

